



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Shkurt 2021

Nr: 44

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË TROPOJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, ZJ. ALBANA MUHARREM HYSENUKAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, paragrafi 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës

VËREN:

Me shkresën nr. 21 prot., datë 06.01.2021, Këshilli i Bashkisë Tropojë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari z. Andrin Mark Qehaja, propozuar nga subjekti Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, është kandidati me numër rendor 11, z. Zeqir Ahmet Byberi.



Data: 9 Shkurt 2021

Nr. 44

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Albana Muharrem Hysenukaj

Këshilli i Bashkisë Tropojë me shkresën nr. 21/2 prot., datë 20.01.2021, me lëndë dërgim informacioni, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se z. Zeqir Ahmet Byberi, rezulton se ka ndërruar jetë më datë 23.07.2019.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vijoi procedurën e mëtejshme të konstatimit të kandidatit të rradhës, sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në përputhje me parashikimet neneit 164, paragrafi 2, ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, është kandidati me numër rendor 12, zj. Albana Muharrem Hysenukaj.

Me shkresën nr. 609 prot., datë 26.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Tropojë, zj. zj. Albana Muharrem Hysenukaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 004 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Albana Muharrem Hysenukaj, në këshillin e bashkisë Tropojë, rezulton se, në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar mbiemrin nga “Gjongecaj” në “Hysenukaj”.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 828 prot., datë 03.01.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 811 prot., datë 02.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Albana Muharrem Hysenukaj, në këshillin e bashkisë Tropojë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Tropojë, zj. Albana Muharrem Hysenukaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1134/1 prot., datë 08.02.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Albana Muharrem Hysenukaj, në këshillin e bashkisë Tropojë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar paragrafit 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, të dhënat e kandidati për anëtar zj. Albana Muharrem Hysenukaj, në këshillin e bashkisë Tropojë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, dhe 164, paragrafi 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



V E N D O S:

1. Zj. Albana Muharrem Hysenukaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Tropojë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Albana Muharrem Hysenukaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Osmanaj _____
B.Kodra _____
M.Koja _____
Y.Merkaj _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2021

